

Intervistë me kandidatin për kryebashkiak të Pogradecit, Aleanca "Punë dhe Dinjitet", z. Eduart Kapri

Shtrati i Fjalës sime është e vërteta!

Shtrati i Besimit në Fitore është populli i mençur dhe punëdashës i Mokrës!



Mokra është vendi i origjinës, dhe i im, i babait tim, i gjyshërve dhe më thellë në trungun e familjes. Mokra është vendi im, besoj se kjo i thotë të gjitha.

Kur mendoj për Bashkinë e madhe të Pogradecit, nuk mendoj veçanërisht për një zonë të caktuar, mendoj për të gjitha, në formë të njëtrajtshme, i shikoj të gjitha me të njëjtin interes, sepse kudo jetojnë njerëz dhe banorët e Pogradecit kudo që ndodhen, duhet të trajtohen si të barabartë, duke i dhënë vëmendjen e duhur çdo fshati dhe çdo banori, pa dallim.

Por sigurisht që unë jam krenar për vendin e origjinës, për Mokrën historike, për burrat dhe gratë e Mokrës, për gjithçka mbart kjo trevë që ka nxjerrë burra dhe gra të denjë për familjen dhe shoqërinë. Mokrarët janë njerëz të punës, me mokrarët gjërat janë të pastra, të padjallëzuara, me mokrarët gjërat thuhet hapur dhe diskutohen në tavolinë, atje ku merren dhe vendimet.

Mokrarët i kam dhe do i kem mbështetje përgjatë mandatit qeverisës në Bashki dhe sigurisht që maksimalisht do i mbështes, sepse është një prej zonave të harruara dhe të lëna pasdore, paçka se të shumtë jana ata që kanë premtuar fjalë boshe, që në fund konsiderohen mashtrime. Sigurisht Mokra nuk është atje ku duhet të ishte, pas 25 vitesh pluralizëm politik dhe pas 25 vitesh në ekonominë e tregut të lirë.

Bajazit Karriqi: Punë dhe dinjitet për Përrenjasin



Shkolla e mesme e Rrodokalit Sipër merr emrin "Skënder Durbaku", mësuesit të paharruar

RIORGANIZOHEN DEGËT E SHOQATËS NË TIRANË, KOMBINAT DHE DURRËS

INTERVISTË ME KANDIDATIN PËR KRYEBASHKIAK TË POGRADECIT, ALEANCA "PUNË

Eduart Kapri: "Alternativa ime

Nga Eduart KAPRI

I bindur, i përkushtuar dhe tërësisht i fokusuar në objektivat primare të zhvillimit socio-ekonomik të Bashkisë së Pogradecit, e shtrirë në kufijtë e saj të rinj territorialë, unë dhe të gjithë bashkëpunëtorët e mi (pa dallim përkatësie, por me "pasaportë" individuale profesionalizmin) do të përballemi me banorët e Pogradecit me realizëm, me ide dhe plane të qarta zhvillimi, duke u shtrirë atyre "dorën" për partneritet, pa kompromis me interesa të ngushtë grup njerëzish, por në një përpjekje kolektive për më shumë dinjitet, mirëqenie dhe siguri për banorët e Pogradecit.

Për një zhvillim të integruar, të shumëtrajtshëm dhe të qëndrueshëm, në një terren administrativ dhe funksional që ofron mundësi dhe shanse për të gjithë pa përjashtim, duke mbështetur dhe orientuar aktivitetin publik apo privat të kujtdo, mes një pushteti vendor të destinuar për të qenë nxitësi dhe mbështetës i mirë funksionimit të sektorëve kryesorë të jetës social-ekonomike në Bashkinë e Pogradecit.

Alternativa jonë "Bashkë për Pogradecin" është një formulë e qartë, e fokusuar te vetë individit, duke e parë atë si epiqendër të vëmendjes së punës dhe vizionit të Bashkisë, por edhe si partner të saj në ideimin, hartimin dhe implementimin e çdo projekti, Partneriteti publik-privat do të jetë boshti kryesor i menaxhimit të Bashkisë së Pogradecit, një prej zonave më të rëndësishme në vend, me një hapësirë gjeo-territoriale heterogjene (liqenore, kodrinore dhe malore), me pasuri të pashterslune të natyrës, por dhe me një popullatë vi tale, punëtorë dhe të lidhur ngushtazi me trevën në të cilën jeton.

Drejtimi i Bashkisë si strukturë funksionale, por edhe i Bashkisë Pogradec si territor administrativ, do të ketë profilin e një drejtimi vizionar, largpamës, kolegjal, me një strategji të qartë zhvillimi, me projekte të rriëplanifikuar, të mundshme për implementim, me impakt të menjëhershëm në sektorët kryesorë, ku operon dhe zhvillohet sipërmarrja private, si dhe me organigramë të qartë të funksionimit të strukturave të pushtetit vendor në Pogradec dhe në të gjitha njësitet administrative të tij (në qendrat e ish-komunave).

Alternativa jonë qeverisëse, menaxheriale për Bashkinë Pogradec është sot në tregun elektoral si alternativa e vetme, për një zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë (tregtisë, prodhimit), si një alternativë zgjidhëse dhe pranë problematikave të çdo banori, kudo që ai ndodhet.

Alternativa jonë u distancohet projekteve abstraktë në letra, projekteve që janë larg realitetit dhe që nuk janë kompetencë e Bashkisë, apo vijave dhe kurbave pa horizont që i ofrohen Pogradecit nga të tjerë.

Alternativa jonë qeverisëse ofron projekte të prekshme, që ndikojnë jetën e përditshme të çdo



Të dashur bashkëqytetarët e mi!

Ndihem i privilegjuar që Partia Demokratike, kryesia e saj dhe Kryetari Lulzim Basha me besoi mundësinë për të qënë kandidati juaj për Bashkinë e Pogradecit.

Këtë besim unë dua ta ndajmë së bashku. Mezi pres të shtrëngoj dorën me gjithsecilin prej jush e të flasim së bashku për projektet për Pogradecin, për zhvillimin ekonomik, të turizmit, kulturën dhe qytetarinë pogradecare, të Mokrës, Starovës, gjithë komunave, të lidhjes më të mirë me infrastrukturë të krahinave me qytetin.

Së bashku do punojmë për mirëqenien në Pogradec, të ulim varfërinë e të krijojmë më shumë mundësi për qytetarët tanë.

Së bashku kemi shumë për të bërë dhe së bashku do t'ia dalim.

Juaji
Eduart Kapri

burri, gruaja, të riu, fëmije, sipërmarrësi dhe pensionisti, ofron projekte që ndryshojnë pozitivisht dhe gradualisht jetën e gjithkujt, lidhur me infrastrukturën rrugore, sistemin e kanalizimeve të ujërave të bardha dhe të zeza, hapësirave të gjelbra, lidhur me ndriçimin publik, me taksat dhe tarifën vendore, me shërbimin në komunitet, Alternativa jonë ofron një administratë publike në shërbim të çdo banori, pranë tij, një administratë larg korupsionit që buron nga lidhjet klienteliste, një administratë ku çdo punonjës do e shohë veten si një aset më shumë në zbutjen e krizës, në të cilën kalon vendi dhe rajoni, si një instrument në mbështetje të banorit, për t'i zgjidhur atij çdo çështje dhe problematikë. Ne jemi alternativa ku pushteti vendor nuk është 'autoriteti', por 'motori' i vënies në funksion të çdo ingranazhi të strukturës që qeverisjes lokale, në funksion të së tërës, në funksion të zhvillimit të integruar, të qëndrueshëm dhe pranë standardeve europiane.

Është tashmë një rrugë pa kthim, rruga e zhvillimit të integruar, një strategji menaxhimi e mirëstuduar, e konsultuar me të gjithë aktorët, grupet e interesit, fermerët, sipërmarrësit, shoqërinë civile, komunitetin rom dhe ai egjiptian, të rinjtë, intelektualët dhe partnerë të tjerë që operojnë në zonën e Pogradecit.

Me bindje të plotë, nuk ngutem



po të shpreh se banorët e Pogradecit na e kanë dhënë mbështetjen e tyre dhe po i qëndrojnë përkrah alternativës sonë për zhvillim, duke qenë të bindur se plani ynë për zhvillim është i mundshëm, i implementueshëm, i realizueshëm dhe mbi të gjitha i kalkuluar qartë në vlera buxheti.

Pogradeci, në alternativën tonë të menaxhimit të Bashkisë, shikohet si një pjesë integrale e një territori më të gjerë, sesa vetë territori i shtrirjes administrative. Shikohet si pjesë e Euro-Rajonit, shikohet si një prej zonave më të rëndësishme të Ballkanit Perëndimor, shikohet dhe trajtohet si një prej zonave më atraktive në zhvillimin e turizmit, agro-biznesit, hapësirës sipërmarrëse, artizanatit, peshkimit, industrisë së lehtë dhe ushqimore etj.

Bashkia do të jetë një promotor i rritjes së konkurrueshmërisë në sektorin privat, do të jetë një mekanizëm i fuqishëm në politikën e marketingut të produkteve dhe shërbimeve që ofron Pogradeci, do

të jetë një suportues dhe nxitës i rritjes së prodhimit vendës, dhe padyshim "leva" e përmirësimit dhe konsolidimit të sektorit të turizmit (turizmit veror liqenor, turizmit sezonal, turizmit pakditor, turizmit kulturore-historik, turizmit konferencial, turizmit tema tik, si dhe formave të tjera të alternuara të turizmit).

Bashkia e Pogradecit, nën drejtimin tonë, do të sjellë përmirësim të ndjeshëm të produktit turistik, duke e kthyer Pogradecin në destinacion real turistik, konkurrent të denjë të zonave të përnjashme në Europë.

Bashkia e Pogradecit, që në ditët e para të funksionimit të saj, nën drejtimin e alternativës sonë, angazhohet se do të hartojë në detaje Planin Strategjik të Zhvillimit, një plan i integruar, i argumertuar me qëllime dhe objektiva të qarta në hapësirë dhe kohë.

Plani ynë për zhvillim të integruar është rruga që do të përzgjedhin banorët e Pogradecit, mes votës së tyre, për ta orientuar Bashkinë Pogradec, në katër vitet në vijim, drejt një epoke të re zhvillimi vizionar.

Bashkia e Pogradecit do të transformohet në vatër të migrimit të ideve dhe partnerëve (vendës dhe të huaj), do të shndërrohet në akumulator projektësh me impakt dhe ndikim të menjëhershëm në zhvillimin social-ekonomik, në përmirësimin e cilësisë së jetës së çdo banori që meriton të mbështetet për të jetuar denjësisht.

NJIHUNI ME EDUART KAPRIN

Eduarti është 45 vjeç dhe vjen një familje e njohur qytetase. Ai është djali i vogël i Qemalit dhe Fetijes, dy prindër të respektuar në qytetin e Pogradecit që dhanë gjithçka për shkollimin e 5 fëmijëve të tyre.

Eduarti rrjedh nga një derë e njohur patriotike e zonës së Mokrës e cila ka dhënë shumë për krahinën përgjatë momenteve më të vështira të saj. Ai nisi shkollën e mesme Tregtare në Vlorë e më pas studimet e larta i përfundoi në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Ekonomisë ku u diplomua si financiar.

Me përfundimin e studimeve, ashtu si shumë të rinj të brezit të tij, edhe Eduarti provoi jetën e vështirë të emigracionit. Ai jetoi dhe punoi për 5 vite në perëndim, në Gjermani ku punoi dhe drejtoi edhe një biznes shërbimesh.

Në vitin 1998, Eduarti u kthye në Shqipëri ku nisi të punojë në administratën publike si ekonomist deri në vitin 2003. Duke besuar tek iniciativa private dhe zotësitë e tij në biznes, Eduarti nisi të manaxhojë në kompani private. Prej vitësh ka drejtuar kompani të sukseshme në tregti dhe ndërtim duke dhënë një kontribut për ekonominë e qytetit e duke punësuar me dhjetra qytetarë pogradecarë.

Përfshirja e tij në politikë ka nisur herët, kur vetëm 30 vjeç konkuroi denjësisht një garë që mbahet mend për deputet në zonën e Mokrës në sistemin maxhoritar në vitin 2001.

Falë cilësive të tij, Eduarti u votëbesua nga qytetarët e Pogradecit në Këshillin Bashkiak dhe që nga viti 2011 ka shërbyer si Kryetar i Këshillit Bashkiak. Në krye të Këshillit, Eduarti ka një kontribut në nxitjen e mjaft projekteve në qytet si dhe ka treguar se i shërben interesit qytetar.

Ka treguar cilësi si manaxher në biznes dhe politikan duke punuar me parimin që çdo punë kërkon njeriun e duhur.

Eduart Kapri ka dëshmuar se merr përgjegjësi dhe di të çojë ato deri në fund. Familja, komunikimi i hapur me njerëzit dhe serioziteti janë cilësitë e Eduartit dhe një garanci për sukses në drejtimin e Bashkisë së Pogradecit.

Eksperiencia e tij e vyer në manaxhim dhe në njohjen e probleme të Pogradecit u vlerësuan nga Partia Demokratike e cila i besoi kandidimin për kryetar të Bashkisë së Pogradecit. Motoja e tij në këtë fushatë është qytetari pogradecar, nga qyteti në fshat, hallet dhe problemet e tij. Bashkë me ekipin e tij, ai angazhohet për punë dhe mirëqenie. Sfidat e tij është edhe ajo e qytetarëve pogradecarë, kthimi i shpresës.

Eduarti është zotuar se dera e tij si kryetar i ardhshëm Bashkie do të jetë e hapur për të gjithë bashkëqytetarët e tij.

Ai jeton në Pogradec dhe është i martuar me Jerinën e cila është ekonomiste. Ata kanë 3 fëmijë, Dei, Eda dhe Eriku.

DHE DINJITET”, Z. EDUART KAPRI

për Pogradecin dhe Mokrën”

Nga Flori SLATINA

Pas 23 qershorit Mokra do të jetë në një njësi administrative të vetme, me qendër Pogradecin. Kryetari i ri i kësaj bashkie urojmë të jetë bir i Mokrës dhe kjo do jetë jo vetëm në dobi të mokrarëve, por të gjithë bashkisë së madhe. Mes një fushate intensive, me takime thuajse në çdo fshat e në çdo zonë, me premtime konkrete, me punë e jo fjalë e prettime boshë, z. Kapri ka fituar besimin dhe mbështetjen e shumicës. Ai e ka për krenari të qenit mokrar, është një personalitet që di të fitojë dhe di të administrojë më së miri qytetin. Njeri që i flet puna vetë. Pogradeci ka nevojë për Edin jo edë për karrigen e bashkiakut. Besimi tek alternative e forcës politike që ai përfaqëson dhe aftësitë e tij intelektuale do ta çojnë, pas 23 qershorit, në krye të Bashkisë së Pogradecit.

1. Ju jeni biri i Mokres dhe Mokra ne keto zgjedhje perfaqeson thuajse gjysmen e elektoratit. Kam parasysh tre komant, por shume mokrare kane zbritur ne qytet e komunat Starove e Hudenisht. Cfare eshte Mokra per ju dhe cili eshte premtimi juaj per keta mokrare?

Mokra është vendi i origjinës, dheu i im, i babait tim, i gjyshërve dhe më thellë në trungun e familjes. Mokra është vendi im, besoj se kjo i thotë të gjitha.

Kur mendoj për Bashkinë e madhe të Pogradecit, nuk mendoj veçanërisht për një zonë të caktuar, mendoj për të gjitha, në formë të njëtrajtshme, i shikoj të gjitha me të njëjtin interes, sepse kudo jetojnë njerëz dhe banorët e Pogradecit kudo që ndodhen, duhet të trajtohen si të barabartë, duke i dhënë vëmendjen e duhur çdo fshati dhe çdo banori, pa dallim.

Por sigurisht që unë jam krenar për vendin e origjinës, për Mokrën historike, për burrat dhe gratë e Mokrës, për gjithçka mbart kjo trevë që ka nxjerrë burra dhe gra të denjë për familjen dhe shoqërinë. Mokrarët janë njerëz të punës, me mokrarët gjërat janë të pastra, të padjallëzuara, me mokrarët gjërat thuhën hapur dhe diskutohen në tavolinë, atje ku merren dhe vendimet.

Mokrarët i kam dhe do i kem mbështetje përgjatë mandatit qeverisës në Bashki dhe sigurisht që maksimalisht do i mbështes, sepse është një prej zonave të harruara dhe të lëna pasdore, paçka se të shumtë janë ata që kanë premtuar fjalë boshë, që në fund konsiderohen mashtrime. Sigurisht Mokra nuk është atje ku duhet të ishte, pas 25 vitesh pluralizëm politik dhe pas 25 vitesh në ekonominë e tregut të lirë.

Si ekonomist që jam dhe si menaxher, besoj i suksesshëm i aktivitetit tim sipërmarrës, kam shtrirë filozofinë time qeverisëse në boshthin e PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT. Mbi këtë linjë do të

Shtrati i Fjalës sime është e vërteta! Shtrati i Besimit në Fitore është populli i mençur dhe punëdashës i Mokrës!



sjell pranë dhe në ndërveprim Bashkinë me Sektorin privat, me objektiv final thithjen e investimeve në zonat rurale.

Një prej projekteve të mia është krijimi fillimisht i Rrjetit të Blegtorëve të Bashkisë së Pogradecit dhe më pas hapja e disa baxhove, për përpunimin e qumështit dhe prodhimin e nënprodukteve të tij, në zonat blegtorale, që blegtori i Mokrës, por edhe i zonave të tjera, të ketë ku ta shesë qumështin dhe të mund të vjelë të ardhura për përmirësimin e racave që mbarështron dhe rrit, për të përmirëuar produktin e parë dhe për të mos u cflitur dhe edur poshtë e lart rrugëve të qytetit për të shitur produktin e tij, që në të shumtën e rasteve i prishet. Krijimi i baxhove, investimi me sektorin privat për to, do të hapë edhe vende të reja pune, kryesisht për gratë, si dhe do të shtojë nivelin e tregtisë në zonat e thella malore, si në ato kodrinore.

2. Ju tashme keni shkëlur thuajse ne cdo fshat. Cili është

komenti juaj per qeverisjen lokale te ketyre viteve? Mandati i fundit i gjithe Pogradeci (1 bashki e 6 komuna kanqe qene majtas).

Të komentosh realitetin që banorët e Mokrës prekin, shohin dhe e jetojnë çdo ditë është jo thjesht humbje kohe, por kalon në traumë. Ajo që mendoj sot është vetëm zgjidhja, që duhet t'u jap unë dhe e gjithë administrata e Bashkisë, problemeve dhe vështirësive që hasin banorët e këtyre zonave në të përditshmen e tyre.

Infrastruktura rrugore, uji i pijshëm, kanalet ujitëse dhe vaditëse, mjedisi dhe pastërtia, infrastruktura e kopshteve dhe shkollave ku mësojnë fëmijët e këtyre zonave, janë plani i punës së përditshme. Dhe ju siguroj që do të jem këmbëngulës, aspak tolerant me paaftësinë dhe korrupsionin, apo neglizhencën ndaj këtyre zonave.

Banorët e këtyre fshatrave dinë të gjykojnë shumë mirë ish-drejtuesit e Komunave, apo këdo që ka qënë në krye të administrimit të Pushtetit Vendor, dhe gjykimi i tyre

do të shprehet me votë. Do të jetë 'Votë Pro' alternativës sime, 'Votë Pro' alternativës sonë, 'Votë Pro' alternativës për punë, punë, punë dhe më shumë mirëqënie.

Nuk i ndaj njerëzit në të majtë dhe të djathtë. Të majtëve dhe të djathtëve u ofroj të njëjtat mundësi dhe u kërkoj të gjithëve mbështetjen. Të majtët dhe të djathtët na duhen që kur të debatojmë në këshill, apo kudo për çështje të komunitetit, të mund të përplasim mendime, për të nxjerrë dhe marrë vendimin më të mirë të mundshëm. Nuk ka të majtë dhe të djathtë që nuk do progresin dhe zhvillimin. Për mua fokus është individi, njeriu, banori, për t'i dhënë mundësinë të jetojë ndryshe, më mirë, larg ekstremit të varfërisë dhe skamjes dhe të mos e mbajë shpresën tek ndihma ekonomike, por do të nxis çdokënd që të gjejë hapësira për të bërë punë, punë së cilës do i marrim frytë, punë në sektorin privat, për të ndihmuar ekonominë familjare.

3. Si kryetar i ardhshëm i

Basskise a do ndikoni fuqishemper Rrrugen "Qukes - Qafe plloce dhe sidomos per rrget lidhese mes fshatrave me rrugen kryesore.

Pa më të voglin dyshim. Megjithëse është jashtë kompetencave të Bashkisë, do të jemi supervisor i Qeverisë në këtë vepër të infrastrukturës rrugore, supervisor për ritmin e punimeve, që ato të përfundojnë brenda afatit të caktuar dhe në cilësinë e duhur.

Përsa i përket lidhjes së fshatrave me rrugën nacionale, këtu më jepni mundësinë të shpalos Planin tim Strategjik "mat" për Zhvillimin e Integruar të Bashkisë Pogradec. Bashkia do e fillojë punën e saj me hartimin e Master Planit Urban - Mjedisor, me specialistë të fushës, shqiptarë dhe të huaj, dhe mbi këtë Plan të Rregullimit të Territorit, do të shtrijmë funksionet, ne si sektor publik dhe sektori privat. Harta e zhvillimit të zonës, busulla, apo udhërrëfyese do të jetë ky Plan, për të investuar me vizion afatgjatë.

4. Rendisni disa prioritete ne per 100 ditet e para sdi kryetar bashkie!

Projekti Strategjik "mat" për Zhvillimin e Integruar të Bashkisë Pogradec është i përqëndruar në tre prioritete sektoriale:

1. Mjedis (hapësira urbane dhe rurale / infrastruktura; mjedisi i parë si hapësirë);

2. Agrobiznes (sigurisht me një vëmendje edhe tek sipërmarrja që operon në zonën urbane);

3. Turizëm (sektor i kushtëzuar nga natyra, vendndodhja, gjeografia, pasuritë natyrore, monumentet e historisë dhe kulturës);

Nëse më kërkon veprime konkrete që do të bëj në 100 ditet e para, ato lidhen me pastërtinë, ndriçimin, ujin e pijshëm, bregliqenin, krijimin e Rrjetëve të Fermerëve dhe Blegtorëve, uljen e taksave për biznesin, bërjen gati të mjediseve mësimore për fëmijët që do të ndjekin shkollën prej mesit të muajit shtator, por dhe shumë e shumë punë të së përditshmes, që nuk mund të mos i shikoj si prioritet.

Do të vijmë në kontakt brenda 100 ditëve të para me të gjithë donatorët që gjenden në Shqipëri, ambasadat dhe partnerët e huaj që kanë projekte të destinuar për Shqipërinë.

5. Cili është mesazhi, thirrja juaj per elektoratin?

Mokra nuk ka nevojë për mesazhe të gjata, për thirrje të bujshme.

Mokra do të zgjedhë djalin e saj, ekonomistin dhe menaxherin e suksesshëm dhe padyshim njeriun që është vetvetë dhe që nuk varet prej askujt, por veçse tek obligimi për të bërë detyrën siç duhet. Prapa meje nuk fshihet askush, prapa meje është vetëm eksperiencia ime, përkrah meje është çdo banor dhe para nesh është një e nesërme që do e bëjmë më të mirë.

Shtrati i i Fjalës sime është e vërteta! Shtrati i Besimit në Fitore është populli i mençur dhe punëdashës i Mokrës!

Shkolla e Rrodokalit merr

Nga Kleant HIDRI

Ajo ishte një ditë për të mos u harruar kurrë. Ishte dita kur ne nxënësit e mësues Skënderit do të vlerësonim punën e tij në breza, dita kur njerëzit e këtij fshati do të vlerësonin njeriun e mirë, kur kolegët do të vlerësonin edukatorin.

Një shkollë që kishte kohë që kërkonte një emër mbi krye dhe një mësues që kishte mëse dyzetë vjet që edukonte fëmijët për rrugën e gjatë të jetës. Dhe ja pikërisht në atë ditë, më 20 maj, në ditëlindjen e mësues Skënderit, me nismën e një grupi kolegësh, të disa shokëve të punës dhe me mbështetjen e komunitetit, si dhe të pushtetit lokal (Këshilli i Komunës në korrik 2014 vendosi në unanimitet të plotë që shkollës së Rodokalit t'i vihet emri i mësuesit të nderuar "Skënder Durbaku"), duke vlerësuar kështu punën e tij mëse 40-vjeçare, vendosja e emrit u bë realitet.

Ajo ditë na mblodhi bashkë nxënës, banorë të komunitetit, ish-nxënës të mësues Skënderit, përfaqësuesit lokalë të komunës, pjesëmarrës nga drejtoria arsimore Pogradec dhe të gjithë bashkë në sajë të respektit për mësues Skënderin.

U organizua një koncert përshëndetës nga nxënësit dhe mësuesit e kësaj shkolle me prezantues maturantin Kleant Hidri dhe nxënësen e klasës së XI Jolanda Novaku, i përgatitur nga mësuesja e letërsisë Eranda Kadilli, mësuesi i muzikës Ledian Lame dhe mësuesi i letërsisë Selami Likollari. Fjala përshëndetëse u mbajt nga drejtoresha e shkollës Kadrie Bufi e cila premtoi mbrojtjen e ambienteve të reja të shkollës si dhe nivel më të lartë arsimor nga nxënësit. Gjithashtu drejtoresha e kësaj shkolle vlerësoi kontributin vullnetar të të gjithë mësuesve në pajisjen e shkollës me kënde dhe mjete të nevojshme për mësim dhe në vecanti punën e mësuesve Përparim Hidri, Bezat Çollari dhe Emanuela Kasmollari për përgatitjen e këndit mbi jetën e mësues Skënderit, me fotografi dhe informacione nga jeta dhe veprimtaria e tij, si dhe një falenderim të veçantë për Flutura Durbakun dhe Dashurie Begon të cilat bënë nga një dhuratë simbolike për shkollën.

Më pas në emër të komunës fjalën e mori për të përshëndetur dhe uruar përjetësi për mësues Skënderin kryetari i komunës z. Fuat Fero. Në fjalën e tij ai ndër të tjera theksoi edhe për kontributin që duhet të japin të gjithë, si për kompletimin me bazë materiale edhe për mirëmbajtjen sa më mirë të gjithë ambjenteve të kësaj shkolle.



I paharruar mbetet edhe kontributi i mësuesit Xhevit Nofulla si një mik i ngushtë i mësues Skënderit, ku ai në emër të kolegëve të vjetër vlerësoi edhe një herë figurën e mësues Skënderit me fjalët më të sinqerta.

Ky koncert u hap me fjalët e familjareve dhe mes emocioneve të forta e duartrokitjeve të sinqerta, më erdhi në mend dita e parë që mësues Skënderi hyri në klasën time: "Isha në klasë të shtatë dhe mësues Skënderin e njihja, por jo se kisha bërë mësim më parë dhe si të thuash kisha pak drojë nga e panjohura. Ditët kalonin dhe cdo ditë e më tepër ne donim të mësonim gjëra të reja, me padurim prisnim orën e "gjuhës shqipe" që të mësonim më tepër nga mësuesi ynë".

Një tjetër moment prekës në vazhdimin e koncertit ishte edhe recitimi nga dy mbesat e mësues Skënderit, Xhulia Male dhe Sara Muçmara, në një poezi kushtuar



atij, një recitim që sinqerisht na preku të gjithëve dhe që u vlerësua me duartrokitje të ngrohta. Shumë nga nxënësit kishin përgatitur poezi për këtë ditë, një ndër to ishte poezia e nxënëses së klasës së tetë Erimelda Hidri, e titulluar "Mësues shumë të deshëm". Gjithashtu nxënësit e klasës së gjashtë kishin përgati-



tur flamurin dykrenar të Shqipërisë me petale trëndafilash të cilin e lancuan me këtë rast.

Nxënësit recituan bukur të gjitha poezitë që kishin krijuar në respekt të punës së mësuesit tonë dhe me fjalën përshëndetëse të drejtoreshës së shkollës me një mesazh nga miqtë dhe familjarët e tij që çdo 20 maj të mblidhemi si në këtë ditë e të kujtojmë mësuesin tonë, u mbyll koncerti. Më pas një grup nxënësish, mësuesish dhe familjarësh me kurora në duar u nisën për të bërë homazhe atje ku prehet i qetë mësues Skënderi dhe që andej u kalua tek ambjentet ku familjarët në shenjë respekti kishin përgatitur një drekë. Dhe kështu u mbyll edhe kjo dite e veçantë.

Disa nga poezitë që janë krijuar dhe recituar nga vetë nxënësit.

"Mësuesi ynë i paharruar"

Krijuar dhe recituar nga nx. e klasës së VI, Afërdita Gazho

Shkolla jonë e dashur shumë afër na ke pasur me mësues të palodhur që ne na kanë folur.

Jemi mbledhur tok të gjithë për një mësues të njohur ai ishte mësues Skënderi që sot e ndriti nderi

Ju Skënder Durbaku si mësues i parë edukove brezat 40 vjet me radhë.

Kurrë nuk do harroresh këtu je gjithmonë je bir i kësaj toke dhe i shkollës tonë.

"Mësues shumë të deshëm"

Krijuar dhe recituar nga nx. e klasës së VIII, Erimelda Hidri

Mësues, shumë të deshëm duke mësuar nga ty nuk reshtëm vije në shkollë plot lumturi dhe na flisje me shumë dashuri.

Me duart e arta notat qëndisje me zemrën e zjarrtë këto fjalë na flisje "të mësosh nuk është detyrim por qejf e argëtim".

Na thoje sa e bukur ishte jeta tani që u rritëm e kuptuam sa vlerë kishte e vërteta këto fjalë të bukura nga ti i mësuar

Të gjithë të kishin zili se si Ti mësues zor gjen në Shqipëri burrë i ndershëm dhe ballëllartë mësues i zgjuar e zemërtartë.

Kur morëm vesh për humbjen tënde i gjithë qielli u bë gri asnjë njeri nuk e besonte se ti mësues ishe i ri.

Mos mendoni se do ta harrojmë tani e kemi në ballë të shkollës me gjithë zemër do ta kujtojmë se ai ishte mësues i fëmijërisë tonë.

emrin "Skënder Durbaku"

Gjyshit tim, Skënder Durbaku

Xhulia Male, shkolla 9-vjeçare "Tafil Rexhepi", 3b, Përg

Sa herë hap dritaren
Qiellin rri vështroj
Me vete them "Pse ike, o gjysh?"
zemrën ma lëndon.

Të gjithë kanë dhimbje,
Të gjithë kanë lot
Por dhimbjen time
S'ma kuptoni dot.

Njeri kaq të mirë,
Asnjëherë s'kam parë
Humba njeriun e zemrës
që na mbante pranë.

Elegji për mesues Skenderin

*Nga Ramadan Kllogjri,
Si një nga nxënësit e
Mësuesit Skënder Durbaku*

Ne ishim të vegjël
Dhe na ndrisnin sytë,
Kur mesuesi për ne
Vinte si prind i dytë.

Ai plot gëzim e buza-gaz
Ndriçon udhën e njerëzisë,
Si dielli që ngroh ditë përditë
Duke ngritur lart pishtarin e diturisë.

Fjalët e arta të mësuesit
Mbushur me rrezet e dijes,
Që njerëzit të shohin larg
Si të hedhin hapat e jetës.

Kolopucë nxënës të urtë
Aq të vegjël fëmijë,
Mësove ti në vite me radhë
Më shumë se dhjetë mijë.

Punove dekada me radhë
I dashur o mësues Skënderi,
Të pandara kemi fjalët e tua
Respekti e krenaria për ty janë nderi.

Në gurët dhe muret e shkollës
Fjalët e tua janë skalitur,
Emri i dashur mësues
Nder fëmijë, gra e burra të thinjur.

Nuk harrohen fjalët e tua
Për ne o mësues i shtrenjtë,
Duke ledhatuar ti na mësoje
Kulturë e respekt për më të mbëdhenjtë.

Kushdo që del në jetë
Dhe dijet e shkollës ka marrë,
Mësuesin e ka gjithnjë aty
E marshon me të i pandarë.

Të gjithë ne që kemi kaluar
O mësues në për duart e tua
Për ndarjen tënde nga jeta
Lotët na rrjedhin si krua.

I nderuar mësuesi ynë
Ne ju kemi borxh mirësinë,
Se ju në kujtesën tonë
Me dëshirë gërshetuat lavdinë.

Ligji i ndarjes nga kjo botë
Është më i fortë se mali,



SKËNDER MEHMET DURBAKU

U lind në fshatin Rrodokal i Sipërm më 20 maj 1948. Shkollën fillore e kreu në fshatin e tij të lindjes, në vitin 1959, ndërsa shkollën 7-vjeçare e mbaroi në Pogradec, në shkollën "Koli Gusho", në vitin 1962. Vazhdoi studimet në shkollën pedagogjike "Petro Nini Luarai" në Korçë, të cilat i mbaroi në vitin 1967, ku u diplomua "mësues". Punoi një vit në Rrodokal Sipër si mësues. Më pas, për tre vjet, deri në vitin 1971, kryen shërbimin e detyrueshëm ushtarak.

Që nga viti 1971 deri në vitin 2011, për 40 vjet rresht, ai punoi me përkushtim, pasion dhe ndershmëri si mësues në Rrodokal dhe motoja e tij e punës ishte "Jeta kërkon dituri! Mësoni, të dashur fëmijë, se dija është domosdoshmëri", duke fituar dashurinë dhe respektin, jo vetëm të nxënësve, kolegëve të tij, por edhe të bashkëfshatarëve, të cilët i donte dhe e donin shumë.

Në janar të vitit 1974 u martua me Farie Vaskun, bijë e Islam Vaskut nga Manastireci, një familje me tradita nga zona e Bërzeshtës.

Bashkë me Farien ata lindën gjashtë fëmijë: katër vajza (Dhuratën, Albinën, Luizën, Sanien) dhe dy djem (Ardin dhe Nefailin), të cilët sot janë martuar dhe kanë krijuar familjet e tyre të nderhme e patriotike, duke zbatuar gjithmonë porositë e atit të tyre të dashur.

Fatkeqësisht, Skënderi u nda nga jeta, pas një sëmundjeje të rëndë, më 20 shkurt 2014, duke lënë në pikëllim të madh jo vetëm familjen, farefisin, kolegët, ish-nxënësit e tij të dashur ndër breza, por të gjithë ata që e kishin njohur.

Ah të ishte pak më ndryshe
E zemra mos këputej nga malli.

Sa mali i moçalit
Është për ne pikëllimi,
Si rrëketë e shiut
Na dalin lotë përmallimi.

Na preke të gjithëve
Moj vdekje tinzare,
Me halle mbi kokë
Ti moj bota ziliqare.

Ti në zemrat tona
Do të mbetësh ngaherë,
O mësuesi ynë
I shtrenjti Skënder.

Ne krenohemi me ty
Se gatove për ne fjalë nderi,
Lavdi të qoftë për jetë
O mësues Skenderi.



FALENDERIM!

Në emër të familjes shpreh edhe një herë falenderimet e mia dhe të gjithë familjes e fisit tim, për nderin që i bëtë vëllait, Skënderit, në një ditë të veçantë siç është data 20 maj, dita e lindjes së tij. Gjej rastin të falenderoj të gjithë kolektivin e mësuesve dhe nxënësve të kësaj shkolle, ku im vëlla shkriu tërë jetën, rininë dhe dijet e tij, këtë kolektiv të mrekullueshëm që pranoi që shkolla jonë të merrte emrin e tij. Falenderoj Këshillin e Komunës Proptisht, i cili me vendim unanimit të gjithë anëtarëve, pa dallime partiake, pranoi emrin e shkollës. Falenderoj gjithashtu të gjithë bashkëfshatarët tanë, miqtë, personalitetet që na mbështetën e na nderuan në ditën e vënies së emrit. Falenderoj të gjithë ata që më uruan për këtë ngjarje të veçantë.

Tashmë 20 maji do të jetë një ditë e veçantë, jo vetëm për ne, por edhe për shkollën, brezat e që do të dalin në jetë nga dyert e saj dhe Ju shprehim mirënjohjen tonë familjarisht dhe në gëzime ua shpërblefshim. Ta gëzojmë e ta mbajmë lart emrin e shkollës sonë!

Aris DURBAKU



Me kandidatin për kryebashkiak të PERRENJESIT, Aleanca "Punë dhe Dinjitet", z. Bajazit Karriqi

Punë dhe dinjitet për Përrenjësin

Te dashur banore te Bashkisë Perrenjas!
Fushata tashme ka filluar dhe emocionet e saj na ndjekin pas. Kjo është e ligjshme. Por une mendoj që duhet të leme menjane emocionet dhe të vendosim me mendje të ftohte se për ke do votojme.

Ky shkrim merr shkas nga deklaratimet e kandidatës së LSI-se dhene ne nje nga stacionet televizive.

Une nuk besoj se ky vend ka njezër të paafte sa që kandidatja e partise ne pushtet t'i importoj nga Tirana apo nga Elbasani! Kjo është nje fyerje për banoret e zones pasi ketu ka shume kualitete te inteligjences që do te dine te punojne per te miren e komunitetit. Ne keto 25 vite, edhe pse bashkia ka qene e drejtuar nga te djathtet dhe te majtet, jane bere disa pune dhe jo pak. Pra, kane qene keta kuadro te zones. Eshte tjetër gje që per interesa te partise (rrofte Partia) keta te denigrohen deri ne kete mase! Lidhur me kete deklarim, nuk do te thote as me shume dhe as me pak se nuk do kete vende te reja pune per banoret e zones. Ata do vine nga jashte zone me urdher partie! Edhe pse vend i ri pune nuk mund te quhet kur heq Selamin dhe puneson Islamin!

Une kam deklaruar dhe deklaruar se te gjitha punet do behen nga djemte dhe vajzat e kesaj zone. Nga burrat dhe grate e mencura. Sepse jane te gjitha kapacitetet. Une kam besim te palekundur ne aftesite e tyre.

Te dashur banore!

Ju e shikoni se ne ndihme te kandidatës te partise ne pushtet, vijne ketu per t'i dhene ndihme që nga kryeministri, kryetar partie, ministra dhe zevendes-ministra, etj. Kjo tregon shkallen e larte te panikut që i ka kapur. Kjo tregon me se qarti se ju duhet bashkia per interesat e veta partiake dhe jo per banoret.

Te dashur banore!

Une besoj tek ju ashtu sic besova edhe kater vite me perpara. Ne se bashku do bejme pune shume te mira ne te miren e te gjitheve. Per mua, ne rradhe te pare është qytetari pastaj partia.

PUNË DHE DINJITET.
Kjo është motoja tone

Punën e Bashkisë s'mund ta kritikojnë apo vlerësojnë ata të cilët nuk jetojnë këtu

Gara për Prrenjasin, Karriqi i përgjigjet akuzave të Rirës: "Bllokuat investimet, në dy vjet s'miratuat asnjë projekt të pushtetit vendor"



CV e shkurtër e kandidatit Bajaziti

Emeri: **BAJAZIT**
Mbiemer: **KARRIQI**
Bashkia: **Perrenjas**
Lindur: **22 korrik 1963, Përrenjës**
Profesioni: **Agronom. I diplomuar ne Institutin e Larte Bujqesor per Agronomi te Pergjithshme.**
1988-1991: Specialist ne Ekonomine Bujqesore, Perrenjas.
1991-1992: Drejtor i Ndermarrjes se Prodhimeve Artistike, Perrenjas
1992-1996: Pergjegjes i burimeve ujore, Perrenjas
1996-2008: Specialist i Administrimit dhe mbrojtjes se tokave, Bashkia Perrenjas
2008-2010: Specialist i verifikimit te titujve te pronesise, Prefektura Elbasan
2010-2011: Drejtor i bujqesise dhe ushqimit, Librazhd
2011-2015: Kryetar i Bashkise Perrenjas
Kualifikime: **Menaxhim dhe drejtim te pushtetit lokal**
I kualifikuar ne drejtimi te administrimit te pronave publike

Kryetari i Bashkisë Prrenjas, Bajazit Karriqi i cili rikandidon për një mandat të dytë, i është përgjigjur sulmeve të kandidatës së LSI, Miranda Rira, e cila ka deklaruar në media se në katër vite nuk është bërë asgjë për Përrenjasin. Puna në krye të bashkisë, tha z.Karriqi, është e prekshme dhe shihet e vlerësohet nga të gjithë qytetarët, nga vendgrumbullimi i mbetjeve urbane, rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare, i çerdhes dhe shkollës së Mesme, ndërtimi i ujësllësit të Rashtanit apo dhe investimet në infrastrukturën rrugore brenda qytetit apo dhe rruga që Prrenjasin Fshat me Katjelin duke krijuar edhe një unazë të qytetit, janë vetëm disa

nga investimet e prekshme në Prrenjas. Por, thekson ai, bilanci e katër viteve nuk pret që ta vlerësojnë ata të cilët nuk kanë jetuar asnjë ditë në Prrenjas. Bajazit Karriqi akuzon qeverinë dhe kryeministrin Edi Rama se në dy vitet e fundit nuk miratoi asnjë projekt zhvillimor të bashkisë. "Dua të sqaroj "kundërshtaren" time politike se gjatë dy viteve kur në qeverisje ishte PD-ja, ishim ne që: Hoqëm vendgrumbullimin e plehrave i cili ishte vetëm pesë metra larg qytetarëve. Ju nuk keni banuar këtu dhe nuk e merrni dot me mend se çfarë ere të keqe binin dhe se kjo erë përfundonte tek hundët e qytetarëve duke u kthyer në një bezdisje të tmerrshme.

Ju nuk keni banuar këtu dhe nuk e merrni dot me mend se çfarë smogu krijohej kur ato digjeshin. I gjithë qyteti mbyllte dyer dhe dritare dhe ndalohej qarkullimi në qytet për gati një ditë deri sa të largohej ai tym i zi dhe me një shije të helmët që rrezikonte seriozisht shëndetin e qytetarëve dhe sidomos të fëmijëve. Por sigurisht që ju nuk mund ta dini, por që për mua nuk është e rëndësishme në e dini ju apo jo. E dinë qytetarët. Ju nuk keni banuar këtu dhe nuk mund ta dini se duke filluar që nga çerdhja, kopshti, shkolla 9-vjeçare dhe e mesme, të gjitha pa rrethim. Të linin përshtypjen e ca haneve ku mund të hynte e të dilte çdo kush. Unë arrita të bëj rrethimin

e çerdhes, atë të shkollës 9-vjeçare dhe po vazhdoja me rrethimin e shkollës së mesme. Dhe ndodhi çudia! Partia që ju përfaqësoni, më bllokoi punimet. Sigurisht që kështu do ndodhte pasi po ajo parti në pushtet, pezulloi të gjitha investimet në Shqipëri për të ndërtuar ca sheshe që edhe mund të prisnin pak kohë. Unë arrita të siguroj fonde për ujësllësin e Rashtanit. Mos vallë që edhe këtë duhet ta shikonit ju? Por duhet ta dini. Atë tashmë e di populli i Rashtanit që i gëzohet edhe sot e kësaj dite asaj veprë. U bë rikonstruktimi i shkollës 9-vjeçare Prrenjas Fshat. Nuk di në e keni vizituar, por ajo u bë një shkollë shumë e bukur dhe me ambiente shumë funksionale. Unë arrita të siguroj edhe fonde për rrugën që lidh Prrenjasin Fshat me Katjelin duke u krijuar kështu një unazë e plotë. Por ju nuk keni banuar këtu që ta dini. Por sigurisht që edhe nuk jua kanë thënë. Por e di që edhe nuk kanë ndërmend tua thonë. Çështje fanatizmi partiak. Dhe të gjitha këto vetëm për dy vjet. Le të thotë kryeministri tuaj se ne përfaqësuesit e PD-së nuk kemi dërguar projekte, në një kohë kur ai i ndaloj të gjitha investimet pushtetit vendor. Po më thuaj se kush nga bashkitë apo komunat që drejtojnë socialistët dërguan projekte për miratim? Si mund që një kryeministër i cili pretendon se është i gjithë shqiptarëve të bëjë presione të tilla se nëse ju na votoni ne, gjë që unë nuk e kam vënë asnjëherë në dyshim se, nuk do ketë projekte dhe investime. Nëse kryeministrit tuaj, populli që voton djathtas nuk quhet popull, une nuk kam asnjë faj. Unë vazhdoj punët e mia ashtu siç i kam bërë dhe sigurisht që do t'i bëj akoma më mirë dhe do bëj më shumë", theksoi ai. Për bllokimin e financimit të projekteve të pushtetit vendor nga Qeveria qendrore, z.Karriqi informon Rirën se "dy vitet e fundit që po përfundojnë nën udhëheqjen e PS-së, nuk u dha asnjë fond për bashkitë dhe komunat dhe të gjithë e kanë të freskët deklarimin e kryeministrit që "nuk do ketë më investime"! Duke iu drejtuar banorëve të Prrenjasit dhe votuesve të rinj të kësaj bashkie, z.Karriqi shprehet i bindur se të gjithë së bashku do ta fitojnë këtë përballje për t'i dhënë punë, dinjitet dhe zhvillim qytetarëve. "Kam qenë dhe jam i palëkundur në besimin tim se edhe këtë garë do ta fitojmë së bashku në të mirën tonë. Të ecim përpara! Punë dhe dinjitet! Pa këto, jemi të humbur", deklaroi më tej, kryebashkiaku i Prrenjasit, Bajazit Karriqi.



SHËNIME LETRARE PËR NJË BOTIM

E vërteta e një legjende

-në botimin me titull: "Varka e Shpëtimit", autor Et'hem Fezollari-

Nga Dhimitër Gegprifti

Këto ditë ka dalë nga sh tyti dhe u vu në qarkullim për lexuesin pogradecar dhe më gjerë libri: Varka e Shpëtimit, në të cilin pas gati 40 vitesh i jepet lexuesit një botim dhe njëherësh edhe një dokument serioz nga ku hidhet dritë e vërtetë mbi një ngjarje jo të zakonshme, me përmasa në kufijt e të pabesueshmes, siç ishte jo arratisja (3 korrik 1975), por ikja larg Atdheut, si një nga protestat më të fuqishme të asaj kohe kundër një sistemi shumë të egër e brutal. Pa dashur një ngjarje e tillë e kësaj forme dhe e këtyre përmasave na kujton dhe mund të heqim një paralele me Bajronin, largimin e tij nga Atdheu Angli, por me një ndryshim rrënjësor: Bajroni nuk u kthye e mohoi Anglinë, kurse familja Fezollari nuk e harroi kurrë Shqipërinë dhe një ditë u kthye me dinjitet më të lartë se kurrë dhe gatshme për të marrë detyra e përgjegjësi në kushtet e reja të Shqipërisë.

Vetë libri më detyronte nga faqja në faqe të shkoja më tutje, duke më qartësuar gjithnjë e më

shumë për atë ngjarje enigmë, për familjen Fezollari, për farefisën, miqtë e shokët, kontributet, problemet familjare, shpirtin e butë e demokrat të tyre, patriotizmin dije në luftë, në monizëm dhe sot në Demokraci.

Libri në trajtimin e subjektivit ka një zhvillim linear me 31 pika kulmore, duke filluar nga prejardhja familjare, kontributet në luftën për liri, fillimi i kalvaveve të gjata, të mundimshëm, shumë të dhimbshëm, por edhe të rrezikshëm për jetën. Në të gjithë këtë trajtesë lëvizin dhe veprojnë personazhe real me lidhje miqësore e njerëzore, por edhe persona që kishin marrë detyra tëurvejonin e të denanconin çdo fjalë e çdo veprim të kësaj familje dhe njerëzve të saj. Nga të gjithë këta personazhe spikat Feridoni, Et'hemi Beshiri, Bami, Myrveti e të tjerë, por për asnjë çast dhe për çdo gjë, çdo mendim e veprim do të merret miratimin e nënës heroinë, nëna Kushe. Kordinatori, organizatori, guximtari mbetet Autori i librit.

Nga dita në ditë, nga ora në orë jeta bëhej akoma më e vështirë, ishte kthyer në ferr. 3 korrik 1975. Duhej marrë vdekja në sy në emër të lirisë, tashmë jo një

person, por një familje e tërë dhe jo pak 16 jetë njerëzish, me një varkë primitive, që u kthye në legjendë dhe sot është relike e Muzeut të Shkupit, çanë përmes liqenit me hënë e pa hënë nga ku vdekja ishte vetëm 5 cm largë. Gjenitë e anies e nxorën atë në bregun tjetër Lubanishti i Maqedonisë, pasi kishin udhëtuar për tetë orë rresht me vdekjen,

nga kolloi të shfaqet liria e vërtetë dhe nga këtu drejt një kontinenti tjetër Australia. Por edhe në këto momente nga më të vështirat pas gati 30 vitesh u vjen në ndihmë babai Haku dhe me të drejt Melbourne.

Autori tregon jetën e qetë, të lirë e suksesshme atje për të gjithë familjen, lidhjet dhe raportet me njerëz të tjerë, aktivitetin shoqëror dhe ëndërrën për t'u kthyer përsëri në Atdheun Shqipëri, të cilin e bënë realitet më 22 mars 1992. Autori nuk nguron të shpjegojë rifillimin e jetës, aktivitetin shoqëror, bizneset e të tjera.

-Libri në radhë të parë është një histori familjare, me karakter autobiografik, që dallohet për natyrshmërinë e rrëfimit, thjeshtësinë dhe besnikërinë e tyre, por ai është dhe një dokument famil-



jar, por edhe një dokument për të vërtetën reale për një ngjarje, që tronditi shtetin dhe Diktaturën.

Botimi "Varka e Shpëtimit" është një dosje e hapur në vitin 2015, kur është miratuar Ligjin për hapjen e Dosjeve, i cili do të shuajë kureshtjen dhe do të hedhë poshtë alibit për këtë ngjarje. Në vështrimin artistik ai është pak a shumë një skenar i gatshëm për t'u ekranizuar, jo thjesht në median lokale, por në ato kombëtare dhe më gjerë.

Libri ka në qendër njerëz heronj, një nënë dhe një familje heroinë, që pa tjetër duhet të kenë një titull nderi dhe mund të kishte një titull tjetër, pasi është shkruar më parë për këtë legjendë, por në vargje, me titull: "Varka e lirisë" me autor M.Çallo dhe redaktor L.Deda. Mund të ish titulluar: "Me vdekjen në sy, drejt Lirisë", "Familja Heroinë", "Heroina Kushe dhe heronjtë e saj" e të tjerë.

BEJTEXHIU HODHI FALL

Dy ditë erdhi verdallë
Dhe për fitoren hodhi fallë,
Ishalla falli s'del
Nga "Misionarja" në Katjel.

Keq-qeverisja e "Jezitit"
Dhe fati i keq i Bejazitit,
Duke bërë lepe-peqe
I ra shorti në ditë të keqe.

Ai punoi aq sa mundi
E sipas avazit këmborën tundi,
Po si e panë syte e botes
Ketë le ti'a lemë votës.

Nuk është faji yt o shoq
Se partia na u shkërmoq,
Ajo gropë të madhe hapi
Sa te gjithë na zuri vrapi.

Elektorati ka shumë halle
Si zhgjidh dot as Kina e madhe,
Nuk do fjale e nuk do lajka
As nga Prrenjësi as nga Rrajca.

Një rënkim nga toka ime
Se ky vend kërkon ndryshime,
Fqinjët tanë mbi "raketë"
Ne me gomar si në mesjetë.

Me vjen keq për ty o djalë
Se je fisnik që më parë,
Fajet nuk i ke tinë
Po ai që damkosi Shqipërinë.

Ty të dhimbset vendi jot
Po pa mbështetje se mban dot,
Kush ka gurin e çan arrën
Vëlla-halli vetëm barrën.

Një mesazh ju jap unë
Vëlla e motër në një punë,
Prisni që të vije verdikti
Se partive s'ju djeg shpirti.

Të dy krahët nga një trup
E për vatanë sup më sup,
Pushteti si fusha e Domosdovës
Që ftohet nga floku borës.

Është karrige me përgjegjësi
E për asnjë me tapi,
Dhe cilitdo ti hapet dera
Të tregojë që ka vlera.

Kemi vitet duke pritur
E nga qielli gjë ska zbritur,
U pa dielli që në mëngjes
Un i ziu popull sa do pres?

Ramadan KLOGJRI
Maj 2015



Riorganizohen degët e shoqatës "Pelioni" në Tiranë, Kombinat dhe Durrës

Pas zgjedhjeve të reja që u mbajtën në 9 maj, kryesia e re me kryetarin e saj z. Istreh Haxhillari ka nisur punën për një riorganizim të plotë të shoqatës. Të shtunën u bë riorganizimi i degës së Kombinatit, Tiranës dhe u ngrit nga e para dega e Durrësit. Në qershor do riorganizohet dega e Pogradecit, Përrenjasit etj.

Në Tiranë u zgjodh kryetar Ramadan Klogjeri, sekretar Xhevhahir Shtupa dhe n/kryetar Iliaz Xhika. Ndërsa në degën e kombinatit u rikonfirmua Bujar Qyrku si kryetar dhe Aris Durbaku si sekretar degës.

Duke patur parasysh se ne qytetin e Durrësit, pasi prej disa vitesh janë larguar nga vendlindja jone Moker me dhjetra e qindra mokratë, një kontigjent prej afërsisht 150-200 familje, me angazhimin e z.Istref Haxhillari me date 30.05.2015 u mblodhen për të krijuar degën e shoqatës mokratë "Pelioni". Pjesëmarrja

ishte e konsiderueshme, marrin pjesë familjare nga fshatra te ndryshem te Mokres,nga Velcani, Selca, Verriri, Goliku, Lakteshi, Jolla etj. Në takim kishte te moshuar e te rinj, mund te permendim Barjam Leka, mesues ne pension 75 vjec, Ismail Qyrku, ish mesues 63 vjec, Ilir Blaceri e Jetnor Leka 37 vjec, Albert Alla 32 vjec etj, fakt qe tregon interesim per vendlindjen e tyre. E bejme kete organizim per te zgjeruar njohuritë rreth traditave e zakoneve te Mokres tone por edhe per ta trashегuar tek brezat e ardhshem me takime e biseda mujore, me leximin e gazetes "Mokra", dashurine per vendlindjen e tyre. Pasi biseduan e degjuan dhe nje fjalim te shkurter te kryetarit z. I.Haxhillari, mbi funksionet e veprimtarite e shoqates, vendosem te zgjedhim dhe drejtuesit e degës së Durrësit:

Kryetar: Ilir BLACERI
Nenkryetar: Ismail QYRKU
Sekretar: Hamet PROGA

FESTA!

U festua, po për çfarë?...

-një replikë e padëshiruar-

Nga Dhimitër GEGPRIFTI

Kryetar i shoqatës
"Jehona e Mokrës"

Më 17 maj 2015 në Pleshisht të Mokrës së Sipërme u organizua festa tradicionale, e njohur tashmë Festa e Pleshishtit ose Festa e Mokrës. Organizohet pikërisht në këtë vend për të vetmen arsye se këtu në vitet e zjarra të Luftës Nacionalçlirimtare janë organizuar dy ngjarje të mëdha shumë të rëndësishme në historinë e kësaj lufte me në krye trimin mokrat Reshit Çollakun me mokratë të tjerë: Krijimi i Çetës së Mokrës 27 mars 1942 dhe Batalioni i Mokrës më 17 maj 1943.

Jehona e kësaj feste është pasqyruar dhe në faqet e gazetës "Mokra", f.3, nr. 6 (201), maj 2015 me dy shkrime: një kronikë dhe një fjalë përshëndetëse.

Kjo festë u organizua nën moton: LAVDI PËR JETË BATALIONIT TË MOKRËS ME KOMANDANT RESHIT ÇOLLAKUN! Korrespondenti i kësaj gazete, autor i kronikës shkruanë "Ditën e dielë më 17 maj u shënu në fshatin Pleshisht përvjetori i 72-të i krijimit të Çetës së Mokrës, që më pas u quajt Batalioni "Reshit Çollaku"... Në momentin e krijimit të batalionit është quajtur Batalioni i Mokrës dhe pas rënies së Reshitit në fushën e nderit, Epopeja e Pojskës, 16 korrik 1943, mori emrin e tij. Çeta e Mokrës e ka datën e krijimit në mars 1942, jo 17 maj, sivjet mbushi 73 vjet dhe jo 72, që

mbush batalioni!...dhe vazhdon:" Ishte e pranishme zonja Diana Mile, kandidat e Aleancës qeveritare për bashkinë e Pogradecit në zgjedhjet e pritshme lokale...!". Zonja Diana Mile është kandidat e koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane" dhe jo ashtu si është shkruar më sipër. Edhe folësit e tjerë i janë referuar krijimit të çetës, meqë aktiviteti u zhvillua më 17 maj...të cilët u kërkuan pjesëmarrësve të mbështetnin kandidaturën e zonjës D. Mile. Nuk është folur konkretisht për betejat e këtij formacioni luftarak, historiku i këtij batalioni, dëshmorët e të tjerë?

Në dokumente thuhet: "Në qarkun e Korçës deri në dhjetor të 1942 ishin formuar 18 çeta, midis të cilave ajo e Mokrës (Pogradec) (27 mars 1942, sh.ynë), ndërsa nga tetori i 1942-it deri në maj të 1943-it, numri i çetave partizane u rrit akoma.

Më vonë me rritjen e numrit të forcave të kryengritjes së armatosur, nga çetat u krijuan batalionet partizane, si Batalioni i Mokrës, (17 maj 1943, sh. ynë) i Gorës, Kolonjës, Prëzës, Mali i Thatë, Batalioni "Shqiponja"...". Gazeta "Veterani", OBVL.

Dikur në monizëm, kur kërkohet të zbatoheshin rregullat e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1973), është shkruar një shkrim me titull: "Gabim i ndriçuar me llamba neon", i cili bënte fjalë se mbi Pallatin e Kulturës në Tiranë ishte shkruar me neon: "Pallati Kulturës" dhe ky shkrim nuk është as më shumë as më pak, nuk është gabim drejtshkrimor, por diçka më shumë...

Nga Llazi TONA

Evropa Juglindore hapësira ku në jetojmë, ka qenë arenë e përplasjeve të fuqishme kulturore, racave, ideve e interesave të mëdha, gjë që ka sjellë migrimin (largimin), e vazhdueshëm të popullsisë autoktone.

Romanët kolonizuan Ilirinë në – 168 vjet para Krishtit. Vetë krishterimi zbriti herët, që në zanafillën e tij, në breg të detit dhe dalëngadalë hyri në thellësi të vendit, gjë që shihet sot në rrënojat e kishave të shumta paleokristiane në të gjithë territorin e vëndit tonë.

Ilirët që ishin të krishterë dhe bënë pjesë në patriarkun e Romës, pavarësisht latinishtes zyrtare, ruajtën e mbajtën gjallë gjuhën e tyre, pasardhëse e së cilës në të shumtat e leksikut të saj është shqipja e sotme.

Serbët, stërgjyshërit e tyre sllavë paganë të pafe u vërsulën në sininë e Hemusit (Ballkanit) me turma të mëdha në shek. VI dhe VII pas Krishtit, si një masë dërmuese mbi banorët autoktonë të kësaj sinie, mbi iliro-arbërit. U përpoqën pa masë, në fund nuk mundën t'i shfarosin pasi siç dihet vendasit ishin të ngurtë (konservatorë) në sjellje, në mënyrat e veprim-it, ritet e tyre. Ata u tërhoqën në kështjella e majave të maleve.

"Të krishterët", shkruan Presbyter Diokleas, "duke parë veten në mjerim dhe të persekutuar, u tërhoqën në male dhe ndër-tuan kështjella fortesa për të shpëtuar nga duart e sllavëve gjersa t'i vinte Perëndia në ndihmë e t'i çlirointe".

Asnjëri nuk ka mundur t; i shuajë dhe kjo për shkak të instinktit të fuqishëm të racës që i ka dhënë forcën t'i qëndrojnë Perandorisë Romane dhe rënies së Bizantit, të dalë gjallë nga rrebeshi i Perandorisë Bullgare e serbe dhe më pas nga gërmadhat e Perandorisë shekullore otomane-turke. Megjithatë, largimet masive nuk u resh-tën. Kështu që në shek. XV, shumica e arbërve, të krishterë katolikë e unite, për të mos u bërë preh e barbarisë otomane, për të mos islamizuar njerëz të çmuar, të ndershëm, të besës dhe trima që u përleshën me bandat turke, u detyruan të lëshonin vendbanimet e tyre dhe vendosen të nguliten nëpër vendet e tjera të Kontinentit të Vjetër Evropian, si: Itali, Greqi, Austri, Hungari etj.

Sjellim në vëmendje se nga tmerret një pjesë e tyre shkoi deri në Ukrainë nëpërmjet Greqisë, Bullgarisë, Besarabisë (Moldavia e sotme) dhe një pjesë në Ukrainë. Nëpërmjet këtyre qendrave të rëndësishme ballkanike të transportit, arbrit u drejtuan për t'u vendosur në Odesë të Ukrainës.

Rajoni i Odesës është më i madhi në Ukrainë ndër 24 rajonet e saj ka 1.200.000 banorë dhe kombësi të ndryshme, tre porte të rëndësishme që e bëjnë atë qytetin më të preferuar në transportin detar në Detin e Zi. Është një qytet relativisht i ri pasi është themeluar në 1794, i cili, për shkak të shtrirjes gjeografike bëhet qendra më e rëndësishme kulturore, ekonomike, tregtare, turistike e Ukrainës, me një popullsi të përbërë, si: ukrainas, rusë, bullgarë, grekë, turq, francezë, gjermanë, hungarez, hebrej ku nuk mungojnë dhe albancët (shqiptarë). Frankofoni Hercog Emanuele Derishele, përmendorja e të cilit gjendet pranë portit "Odeuska" mbetet themeluesi i parë i qytetit të Odesës.

Ish kryeredaktori i redaksisë së Radio-Odesor në vitin 90 të shekullit të kaluar Ivan Nenov me origjinë të largët nga Kru-shëva e Ohrit thotë, se: "Në rrethin e Bollgradit të rajonit të Odesës banojnë 80 mijë albancë (shqiptarë) – Bollgrad, është një qytet afër qytetit Ismail në kufi me Rumaninë. Në vitin 1806-1812 lufta ruso-turke mbaroi me nënshkrimin e marrëveshjes së paqes në Bukuresht. Ajo fik-soi bashkimin e Besarabisë me Ukrainën. Në këtë zonë ndodhet gjithashtu kolonia e Karakurtit, të cilën albancët e kanë emërtuar "Albania" dhe konsiderohet si kryeqendra e albancëve (shqiptarëve) të Ukrainës. Në të janë ngulitur dhe dy fshatra, Veneriani dhe Çorodoli të Mokrës së Sipërme në Pogradeç të cilët boshatisën tërësisht vendbanimet e tyre për t'u vendosur në këtë koloni arbëreshe të Ukrainës për shkak të

Shqiptarët e Ukrainës



bandave turke. Në të janë vendosur gjithashtu një numër jo i vogël i qytetarëve të dikurshëm të Llëngës, nga djegia që bënë otomanët më 1762.

Sipas kodikut të kishës së Shën Prokopit në Tiranë: "Në 2 shkurt 1762 u prish Voskopoja, Niça, Llënga, Grahova, me një zhvillim të lartë ekonomik-kulturor". Kjo ishte arsyeja që pjesa më e madhe e këtyre qytetarëve u shpërngulën për në Greqi, Austri, Hungari, Rumania. Goditjen e dytë Llënga e mori nga persekutimi i Ali pashë Tepelena ku u dogj Llënga, Niça, Shpaska e Voskopoja, banorët e të cilave morën emigrimin në drejtim të Bullgarisë përsëri për në vendet e sipërshtuar. Në këtë kohë u bë një largim masiv i arbërve nga trojet e tyre. Kështu banorët e Hormovës, emigruan në drejtim të Bullgarisë, ata të Lazaratit (pranë Gjinokastrës) ikën tërësisht në Thraki, si pasojë e pushtetit të Kapllan pash Delvinës, etj.

Prej kohësh ka patur një valë emigrimesh nga Arbëria në Bullgari, nga të dhënat e studiuësit bullgar D. Jazanov dhe duke i zhveshur ato nga pikëpamja nacionaliste-shoviniste e tij, gjejmë shumë gjëra interesante lidhur me atë se "arnautët" e Bullgarisë janë të shpërngulur nga krahinat e Korçës, Çermenikës, Sapatit, Mokrës, Dibrës e Matit në periudha të ndryshme duke filluar nga shek. X, XV, XIII deri në shek. XIX.

Rreth kolonisë "Albania" janë formuar mjaft fshatra të banuar nga albancët, si: Tuzi (Avenskoe) me 240 shtëpi banorët e të cilët edhe sot, ruajnë një histori sa të hidhur aq të dhunshëm të kohës së Stalinit, të vitit 1933 ku janë vrarë 1000 vetë, të gjithë albancë, ngjarje e cila është mbajtur e fshehtë deri vonë, duke i servirur si viktima të "mortajës" dhe kjo për t'i likuiduar tërësisht fizikisht. Qushku (gjeorgjevka me 170 shtëpi kanë ardhur në pranverën e vitit 1863 kur Katerina e II bëri reforma agrare, se dhe Gjandarmi (Harnov(na) e tij.

Në arkivat rumune u zbulua "Letër nga Kishinjëva" e cila është botuar në shtypin e kohës, sipas gjithë gjasave në vitin 1910 ose 1911 në Bukuresht. Në të midis të tjerave thuhet: "Mësoni që këtu në Besarabi dëgjuam që ka ca fshatra albanca, andaj nuk e besonja, po pa pritur këtë dëshirë, më solli fati të has një albance nga një fshat i quajtur Karakurti i cili ka 400 shtëpi (familje), përmbi 2000 shpirt, fjalën shqiptar se njohkan, si zura unë të thoni si kanë ardhur dhe të tjera, një tha prej ca qindësh vjeç gjenden, aty dhe s'kanë dashur të kryqëzohen me të huaj, andaj dhe quhen e flasin mirë, nuk kishte fatin, njeriu që paqja, të dijë se ka shqiptarë shumë në botë... dhe jemi prej një gjaku".

Në fakt bota na njeh si albanë që, e shqipëzuar në gjuhën e sotme shqipe, do të thotë "të bardhë".

Është për t'u çuditur këtu në Shqipëri që kremtimi për Heroin Legjendar, heroin e Evropës Gjergj Kastriot Skënderbeut



bëhet vetëm me 17 janar (1468), ditën kur ai ndroi jetën. Në "Albani" (Karakurt) festojnë më 23 prill, ditën e Shëngjergjit kur ai ka lindur. Ajo kremtohet në mënyrë madhështore, sepse kjo datë sipas albancëve lidhet me datëlindjen e tij, në rrugën kryesore me tavolina plot dhe kështu duke vizituar e uruar njëri-tjetrin, ditën e Shën Gjergjit tërë natën. Ndërsa ditën e Krishtlindjeve përgatisin për secilin nga 12 piata, duke llogaritur kështu 12 apostujt e Krishtit.

Në një bashkëbisedim mbi kishën e të kremten në Albani (Karakurt) më 13 gusht 1993, një e moçme shprehet se: "Patëm klishtë shumë të bukur pa e rënë" pyetjes së studiuesve shqiptarë nga Maqedonia S. Mysliu dhe A. Dauti, se: "Kush i rrënoi". Komunizmi?! "E moshuara u përgjigj: "Jo biro, komunizmi prishi nariun e pastaj ai (njeriu) prishi Klishtë (Kishën)".

Gjatë vitit 1809-1819 të shpërngulur nga vendbanimet e tyre shumë arbër u vendosën në rajonin e Odesës dhe themeluan fshatra, si: Kubej (Çernonoaragjoje), Tashbunarë (Kamenka), Çjilija (Ogorodnoe), Çeçmjac - Varunta (Krinicnoja) etj.

Sipas të dhënave, më 1809-1810 në Besarabi të Ukrainës u vendosën 300 familje albancë të ardhur nga Matrica dhe Arbana të Bullgarisë. Këto familje sipas Akademikut N.S. Derxhavin u vendosën në fshatin Katur Çumaj në bregun e djathtë të Lumit Japlov. Ndërsa në vitin 1862 një pjesë nga të ardhurit albancë u vendosën në bregun e detit Aznov në rrethin e Bardjanskut në Gurber në Tavriçesk ku ngritën tri koloni të tjera.

Sipas Mihal Uzuni, drejtor i shkollës së Karakurtit në vitet 90 të shekullit të kaluar, me origjinë albance: "Në krime ka 6 fshatra të banuar me arvanitas". Interesant është fakti që jep ai për një grup tjetër albance që hynë në përbërje të batalionit grek të komanduar nga kapitanit Stefan Mavro Mihali, gjatë luftës ruso-turke të vitit 1790.

Hulumtuesi dhe statistiku i njohur i qarkut Novesekskik, A. Shallovski në vitin 1950 shkruan, se: "Batalioni grek të formuar nga kapitan Stefan Mavromëhali, ushtarët e tij, nuk ishin grek, po arvanitas. Ata quheshin në mes tyre Albancë dhe një pjesë e tyre greke shumica e tyre flisnin Albanisht. Këta albancë u vendosën në 7 fshatra në mes Bakllavasë dhe Jaltës-

Kadisaj, Allsi, Kamari, Kermençik, Ballta, Sorak, Ataka.

Mihal Stefani, albanec i kolonisë "Albania" (Karakurt) në librin "Si erdhën albanecët në Ukrainë" ndërmjet të tjerave shkruan: "Në vitin 1765 nga Arbëria ikën nga bandat turke. Pas përleshjes me banda të tilla ata janë detyruar të banonin vendbanimet e tyre dhe të nguliten në Bullgari dhe krijuan fshatrat tona. Sipas disa dokumenteve të Besarabisë (Ukrainë) në vitin 1806 erdhën familjet e para albancë nga Bullgaria si: Derventi, Bozaxhi, Gjorgji, Kirçevi etj. Grupi i dytë erdhi në Odesa dhe u vendosën të gjithë në një lagje ku ndërtoan shtëpitë e tyre e që sot. Odesa ka dhe një rrugë me emrin "Balshaj Albaneski" (shqiptarët e mëdhenj).

Nuk mund të harrojmë këtu edhe fakte të tjera të njohura të historisë, të cilat tregojnë që albancët morën pjesë në themelimin e qytetit të Odesës, dhe, sipas Urdhrit të Qeverisë të asaj kohe datë 29 dhjetor 1819, i cili përbante privilegje të mëdha për të ardhurit merrnin 60 desnjatinë (1 desnjatinë = 1.092 hektarë tokë), hua të mëdha, favore, liroheshin nga shërbimi ushtarak e taksat për 10 vjet.

Më 1991 u mblodh kuvendi i albancëve në Albani (Karakurt) dhe themeloi shoqatën "RILINDJA" për gjithë Albancët e Ukrainës që deri në klasën e 4 fillore, mësimin në shkollat e tyre të lejohej në gjuhën amtare Albane (shqip) dhe të sigurohej dy bursa për filologji-histori në Shqipëri.

"Kur isha në Shqipëri dhe i shtrova këtë kërkesë Qeverisë së Shqipërisë – shkruan Ramadan Çilku më 1995 – mu përgjigjën, nuk kemi gjëndje për këtë.

Në novelën "Kirgilesi" shkruan shkrimtari i Madh Pushkin, flet për disa albancë (shqiptarë) të cilët i përshkruan si njerëz të lartë, shtatmëdhenj, me kësula të bardha në kokë dhe plot entuziazëm ku midis të tjerash shkruan:

"Pranë grykës së varfër të Përoit

Ndodhet i panjohur katund

Me familjet albanec, bullgarë, gagauzët këtu

Në egërsi të pakujdesshme kanë jetue

Duke ruajtur ritet prindërore".

Albancet e Ukrainës e ruajnë shumë mirë gjuhën e tyre amtare. Vetën e quajnë albancë, bullgarët i quajnë "shkla".

Me shprehjen "ti shqipton, si ne" ata thonë "A kupton si ne". Tek Albancët në të folurën e përditshme të tyre, bie në sy ruajtja e grupeve KL, dhe GL, si Klumësht, Klan, Klishtë, gusht, glu, etj. Këto grupe i gjejmë tek Buzuku (1555), Budi vonë, pësojnë një patltilizim jetër që japin q e gjnë: qumësht, qan, kishë, gjuhë, gjisht etj. Ato janë ruajtur deri më sot në formën e grupeve KL e GL në dialektin e arbëreshëve të Italisë dhe greqisë.

Gjithashtu monoftongizmi i diftongëve ua, ie, ye, në, u, i, g si tek du, muj, dur, geu, shemturë, dill, mill, etj. Monoftongizmi, vihet re jo vetëm në fjalët ku grupi ie është kthyer në je si në viher (= vjerë), tirze (= tjerxe) etj.

Fenomenin e monoftongizimit e gjejmë edhe tek Teodor Haxhi Filipi (Dhaskal Todri) në gjysmën e shek.XVIII, por jo të përgjithësuar, pasi ai shkruan herë me ue, ua, ye, ie, e here me u, y, i, gjë që tregon vazhdimësinë e traditës së moçme të të shkruarit. Këtë fenomen, te ua, e te ie e gjejmë dhe në të folmen e arbëreshëve të Montecilfonës (Kampobasso) në Itali. Kështu, helmur (= helmuar), shkrunj (=shkruan), mikre (= mjeker), i miri (= i mjeri), të tirët (= të tjerët), të njëjtat me format e të folurës së albansëve të Ukrainës si: viher, tirre etj.

Këtë fenomen e gjejmë sot në krahinat e bregut të majtë të Shkumbinit, në Shqipëri.

"E vërteta" – thotë Akademiku albanc (shqiptar) Fjodor Dermenthi, një nga figurat më të shquara të Ukrainës "është në të kaluarën dhe e kaluara është bashkë me ne, sepse pa "të s'ekziston e ardhmja".